

VENDIM
Nr. 43, datë 2.9.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR VEPRIMTARINË
VALUTORE”**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “c”, të nenit 43 dhe shkronjave “d” dhe “dh”, të pikës 3, të nenit 60, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për veprimtarinë valutore”, miratuar me vendimin nr. 70, datë 30.9.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. përmbajtja e pikës 1, shkronja “c”, ndryshohet si më poshtë:

“c) ligjin nr. 62/2020, datë 14.5.2020, “Për tregjet e kapitalit”; ”;

ii. përmbajtja e pikave 3 dhe 4 ndryshohet si më poshtë:

“3. “Rezident” – është çdo person fizik, person juridik ose njësi institucionale që ka qendrën e interesit ekonomik në territorin e Republikës së Shqipërisë, zakonisht për një periudhë jo më të shkurtër se 12 (dymbëdhjetë) muaj, sipas ndarjeve të mëposhtme:

a) Personat fizikë – Personi fizik konsiderohet rezident kur:

i. banon zakonisht në Republikën e Shqipërisë dhe/ose ushtron aty veprimtari ekonomike në mënyrë të qëndrueshme,

ii. nuk ndryshon rezidencën jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç se për arsye studimi, trajtimi shëndetësor, shërbimi të përkohshëm apo udhëtimi jashtë vendit;

b) Personat juridikë dhe njësitë institucionale – Një person juridik ose njësi institucionale konsiderohet rezident(e) kur:

i. është i(e) regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, ose

ii. ka vendin e menaxhimit efektiv apo qendrën e operacioneve kryesore në Republikën e Shqipërisë;

Për qëllime të kësaj rregulloreje, “njësi institucionale” nënkupton çdo entitet ekonomik që ka kapacitet të zotërojë asete, të marrë përsipër detyrime dhe të kryejë transaksione në emër të vet;

c) Degët dhe zyrat e përfaqësimit, ku:

i. degët e jorezidentëve në Republikën e Shqipërisë trajtohen si njësi rezidente,

ii. degët e rezidentëve jashtë Republikës së Shqipërisë trajtohen si njësi jorezidente;

d) Sektori publik jashtë vendit dhe organizatat ndërkombëtare, ku:

i. njësitë diplomatike/konsullore dhe kontingjentet ushtarake të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, konsiderohen rezidentë të Republikës së Shqipërisë,

ii. organizatat ndërkombëtare të vendosura në Republikën e Shqipërisë konsiderohen jorezidente dhe personeli i huaj i akredituar konsiderohet jorezident;

e) Njësitë jofitimprurëse (Non-Profit Institutions Serving Households - NPISH), entitetet me qëllim të posaçëm (Special Purpose Entities - SPE) dhe struktura të ngjashme, ku:

i. njësitë jofitimprurëse konsiderohen rezidente kur ushtrojnë veprimtarinë e tyre kryesisht në territorin e Republikës së Shqipërisë,

ii. entitetet me qëllim të posaçëm (SPE), shoqëritë zotëruese, fondet apo subjekte të ngjashme klasifikohen sipas vendit të regjistrimit ose të menaxhimit efektiv.

Klasifikimi i rezidencës për zbatimin e kësaj rregulloreje bazohet në parimin e qendrës së interesit ekonomik dhe interpretohet në përputhje me Manualin e Bilancit të Pagesave (Balance of Payments Manual 6th Edition - BPM6).

4. Të gjithë personat apo njësitë e tjera, që nuk përfshihen në kategorinë “rezidentë” sipas përcaktimeve të paragrafit 3 të këtij neni, do të konsiderohen si “jorezidentë”.”;

b) Në nenin 7, pika 3, shfuqizohet togfjalëshi “në përputhje me dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje”;

c) Në nenin 11, pika 1, togfjalëshi “për shumat mbi 1 milion lekë ose kundërvleftën e tyre në valutë”, zëvendësohet me togfjalëshin “, për shumat mbi 10 000 (dhjetë mijë) euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera,”;

d) Përmbajtja e nenit 14 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Neni 14

Detyrimet e subjekteve për dokumentacionin

1. Dokumentacioni i kërkuar në këtë rregullore paraqitet te subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe ruhet prej tij, sipas parashikimeve të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.”;

e) Kreu VI “DISPOZITA PËRFUNDIMTARE” dhe neni 15, shfuqizohen;

f) Shtojca nr. 1 shfuqizohet.

2. Ngarkohen subjektet e rregullores me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 31 tetor 2026.

KRYETAR
Gent Sejko